

Gratë Ndërmarrëse në Energji

[millenniumkosovo.org/
womeninenergy/grants](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy/grants)

Fuqizuar nga

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës dhe
Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit

Implementuar nga
GFA Consulting Group
dhe HPC AG

WEE

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës po lanson pjesën e dytë të WEE - E MENÇUR, e përbërë nga grante financiare për investime në makineri, pajisje, teknologji të energjisë së rinovueshme dhe masat e efijencës së energjisë për ndërtesat ku operojnë ndërmarrjet. Me programin e granteve, MFK do të ndihmojë gratë ndërmarrëse të investojnë në masa efijente të energjisë dhe t'u mundësojë atyre që të rrisin biznesin e tyre përmes përdorimit më efijent të energjisë.

KUFIRI I GRANTEVE

- Minimumi: >10.000 €
- Maksimumi: 135,000 €
- Kontributi vetanak i aplikuesve: 25% e grantit të pajisjeve

Kriteret e kualifikimit

1. 51% në pronësi të grave: Kompania duhet të jetë së paku 51% në pronësi të grave (dëshmuar nga **regjistrimi i ndërmarrjes**). Gruaja-pronare duhet gjithashtu të jetë e përfshirë në mënyrë aktive **në udhëheqjen e kompanisë**. Kjo gjithashtu do të vlerësohet në një **intervistë të hollësishme** që do të zhvillohet me secilin prej aplikantëve që plotësojnë të gjitha kriteret e kualifikimit dhe që kanë paraqitur një aplikim të vlefshëm.
2. Të paktën 5 punonjës: kjo duhet të dëshmohet nga Pagesa e Kontributeve të Punësimit për 6 muaj, të cilat duhet të dorëzohen së bashku me aplikacionin.
3. Më shumë se 2 vite e vjetër: kompania duhet të jetë regjistruar në ose para 30 dhjetorit 2018, e dëshmuar nga regjistrimi i ndërmarrjes. Nëse kompania juaj ndryshon statusin e regjistrimit, ju lutemi na jepni dëshmi se është vazhdimi i të njëjtit biznes.
4. Dorëzoni prova nga Zyra e Tatimeve (ekstrakt nga faqja e internetit e ATK-së) që kompania nuk ka asnjë detyrim ose borxhe ndaj institucioneve qeveritare.

Thirrja për aplikime për
grante për gratë ndërmarrëse

Gratë Ndërmarrëse në Energji

[millenniumkosovo.org/
womeninenergy/grants](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy/grants)

Fuqizuar nga

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës dhe
Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit

Implementuar nga
GFA Consulting Group
dhe HPC AG

WE

Paketa e informacionit që duhet të dorëzohet

Dëshmia e Kriterëve të Kualifikimit siç është renditur më sipër (pikat 1-4)

Formulari i plotësuar i aplikimit, duke përfshirë:

- Historinë e Kompanisë (shih Formularin e Aplikimit për detajet - Shtojca B);
- Plani i Zhvillimit të Kompanisë (shih Formularin e Aplikimit për detajet - Shtojca C);
- Deklarata Motivuese (shih Formularin e Aplikimit për detajet - Shtojca D);
- Lista e investimeve të planifikuara të pajisjeve (shënim: financimi retroaktiv i pajisjeve nuk është i mundur), përfshirë koston indikative të pajisjeve (duhet të jetë mbi 10,000 €. Nëse jo, ju lutemi aplikoni në grupin e AVANCUAR);
- Regjistrimi i Biznesit;
- Letër konfirmimi nga banka e kompanisë që kompania mund të financojë 25% ose përmes burimeve të veta ose përmes një kredie bankare;
- Pagesat e Kontributit të Punësimit për 6 muaj për të paktën 5 punonjës;
- Deklaratë e nënshkruar që kompania do të përmbushë të gjitha kërkesat e MShS (Vlerësimin e Rrezikut në Vendin e Punës dhe, ku kërkohet, Leja Mjedisore) para verifikimit të projektit. Mosrespektimi do të rezultojë në konfiskimin e grantit;
- Dëshmi nga Zyra e Tatimeve (ekstrakt nga faqja e internetit e ATK-së) që kompania nuk ka asnjë detyrim ose borxhe ndaj institucioneve qeveritare.

Hapat e ardhshëm

Aplikimi juaj duhet të dorëzohet përmes email-it deri me datën **31 janar 2021 në ora 18:00**.

Dorëzoni emailin tuaj në: wee@millenniumkosovo.org

HAPAT E ARDHSHEM

Përgatituni:

Shkarkoni Formularin e Aplikimit duke klikuar në Plotësoni Formularin e Aplikimit.

Grupi i MENÇUR - Punëtorja Informuese me datë 11 janar 2021 në ora 10:00 Regjistrohuni në puntorinë tonë online për të mësuar më shumë rreth procesit dhe kërkesave të aplikimit për grupin e MENÇUR.

Thirrja për aplikime për
grante për gratë ndërmarrëse



MILLENNIUM
CHALLENGE CORPORATION
UNITED STATES OF AMERICA



Gratë Ndërmarrëse në Energji

[millenniumkosovo.org/
womeninenergy/grants](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy/grants)

Fuqizuar nga

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës dhe
Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit

Implementuar nga
GFA Consulting Group
dhe HPC AG

WE

Për t'u regjistruar, dërgoni një email në:
wee@millenniumkosovo.org ose telefononi në: +383 49 722 411

Përpiloni informacionin e plotë të kërkuar siç është renditur në këtë
THIRRJE PËR APLIKIM (shiko më lart).

Nëse keni nevojë për mbështetje në vlerësimin e zgjedhjes së teknologjisë,
na dërgoni email me pyetjet tuaja.

Për të marrë më shumë ide se cilat mundësi shtesë të kursimit të energjisë
mund të ekzistojnë në sektorin tuaj të biznesit, ju mund të gjeni me interes
një nga Punëtoritë tona Sektoriale (shih më poshtë për punëtoritë e
planifikuara për Sektorë).

Punëtoritë sektoriale: për të mësuar më shumë rreth mundësive të
kursimit të energjisë në sektorin tuaj të biznesit, bashkohuni në punëtoritë
tona ku do të diskutohen ide të ndryshme investimesh:

- 12.01.2021 Shërbime të trajtimit të bukurisë
- 12.01.2021 Hotele, restorante dhe catering
- 13.01.2021 Shitje me pakicë për bizneset jo ushqimore dhe ushqimore
- 13.01.2021 Prodhimi i ushqimit
- 14.01.2021 Arsim
- 14.01.2021 Prodhimtari
- 15.01.2021 Shërbime mjekësore
- 15.01.2021 Shërbime të tjera
- 16.01.2021 Tekstil dhe modë
- 16.01.2021 Bujqësi

Webinaret e para në secilen ditë fillojnë në ora 10:00 në mëngjes dhe
webinari i dytë fillon në 15:00. Për t'u regjistruar, dërgoni një email në:
wee@millenniumkosovo.org ose telefononi në: **+383 49 722 411**

Vlerësimi i Aplikimeve:

Procesi i vlerësimit përbëhet nga disa hapa, duke përfshirë shqyrtimin
fillestar të aplikacioneve, intervistat e hollësishme me aplikantët e
kualifikuar.

Lista e aplikantëve të pranueshëm, rezultatet e intervistës dhe paketat
e plota të aplikimit do të paraqiten në panelin vendimmarrës me datë 1
shkurt 2021.

Thirrja për aplikime për
grante për gratë ndërmarrëse

Gratë Ndërmarrëse në Energji

[millenniumkosovo.org/
womeninenergy/grants](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy/grants)

Fuqizuar nga

Fondacioni i Mileniumit i Kosovës dhe
Korporata e Sfidave të Mijëvjeçarit

Implementuar nga
GFA Consulting Group
dhe HPC AG

WE

Vendimi nga paneli pritet mes datave 15 - 20 shkurt 2021. Të gjithë aplikantët do të informohen me telefon dhe email posa të jetë në dispozicion vendimi i panelit.

Kriteret e vlerësimit që do të zbatohen janë të treguar më poshtë:

Kriteret e kualifikimit dhe vlerësimit — Grupi i MENÇUR

MFK u bën thirrje grave ndërmarrëse dhe grave pronare të bizneseve të paraqesin propozimet që adresojnë kriteret e mëposhtme:

Kriteret themelore të Kualifikimit (kriteret e detyrueshme që duhet të plotësohen):

- Të paktën 51% e biznesit të jetë në pronësi të grave
- Regjistrimi i biznesit
- Të paktën 2 vite në biznes
- Kostoja e investimit të pajisjeve është më e madhe se 10.000 €

Kriteret e Vlerësimit

Aplikimet do të vlerësohen nga një panel i jurisë, sipas vlerësimit bazuar më poshtë:

Vizioni i biznesit dhe ndikimi ekonomik - 30% e pikëve të vlerësimit:

Kjo mund të përfshijë aspekte të tilla si parashikimi i rritjes së shitjeve/qarkullimit kundrejt shitjeve/qarkullimit historik, krijimin e vendeve shtesë të punës shtesë (veçanërisht për gratë), rritjen e kapacitetit dhe/ose zgjerimin e gamës së produkteve/shërbimeve të ofruara në treg.

Inovacioni i projektit - 30% e pikëve të vlerësimit: Kjo përfshinë aspekte të tilla si futja e teknologjive të reja, prezantimi i produkteve ose shërbimeve të reja, të cilat aktualisht nuk janë të disponueshme në Kosovë ose në rajonin ku është i vendosur aplikanti, një lloj koncepti biznesi që përmirëson kushtet e punës dhe mirëqenien e grave, pakicave dhe fëmijëve.

Përdorimi më eficient i energjisë - 40% e pikëve të vlerësimit: Ju lutem vini re, kjo do të llogaritet nga konsulentët e MFK-së, bazuar në llojin e pajisjes së kërkuar dhe merr në konsideratë përdorimin më eficient të energjisë në lidhje me rritjen e kapacitetit që rezulton nga investimi i pajisjeve. Llogaritja bëhet në njësi të prodhimit.

Thirrja për aplikime për
gratë për gratë ndërmarrëse